VENDIM
Nr.786, datë 22.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.613, DATË 13.12.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NDËRTIM E PROJEKTIM TË SHOQËRIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7, 8, 12 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.613, datë 13.12.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Licenca e lëshuar nga shteti përkatës, e legalizuar nga ky shtet, me vulë a-pustil, për vendet anëtare të konventës së Hagës, dhe e legalizuar në shtetin përkatës, për vende joanëtare të kësaj konvente.".

ii) Shkronjat "c", "ç" e "d" shfuqizohen.

b) Në pikat 1 e 2 fjalët "të laboratorëve të kontrollit të materialeve të ndërtimit" shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha